

Forumi i Politikave të Integritimit monitoron nga afër procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe institucionet e përfshira në të, duke u përqëndruar kryesisht në koordinimin ndërinstucional ndërmjet njëjësive dhe dokumenteve dhe raporteve të tyre ligjore. Treguesit e monitorimit dhe rregullat metodologjike përfshijnë aktet normative dhe/ose legjislative të miratuara; aktivitetet e kryera (numri i takimeve, plan-veprimeve, raportet, strategjitë për të adresuar mangësitë e identifikuar nga raporti i KE, etj.); fazën e zhvillimit paraprakisht të instrumenteve; si dhe shqyrtimin institucional dhe publik të rezultateve të arritura.

HYRJE

Ky dokument politikash synon të shtjellojë organizimin e brendshëm institucional në Shqipëri përgjegjëse për integrimin në BE dhe rolin e rëndësishëm të tij në avancimin e aspiratave të vendit kundrejt anëtarësimit në BE. Kjo analizë ofron një prezantim gjithëpërfshirës të strukturave institucionale dhe mekanizmave në Shqipëri, të miratuara për koordinimin e procesit të integritimit në BE, shoqëruar me një prezantim grafik të rrjetit institucional dhe linjave përkatëse të raportimit. Gjithashtu, prezantohen aktet ligjore, përfshirë ligjet dhe aktet nënligjore, si dhe dokumentet strategjike të nxjerra nga institucionet përkatëse qeveritare, duke përfshirë organet e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ.

Në këtë dokument politikash theksohen argumentet kryesore për rëndësinë e krijimit të një strukture institucionale koherente dhe efektive mbi integrimin evropian në Shqipëri dhe evidentohen mangësitë aktuale në koordinimin institucional dhe funksionet e strukturave përkatëse. Gjithashtu, janë dhënë disa rekomandime për të adresuar përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve dhe strukturave koordinuese.

RËNDËSIA E KOORDINIMIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

Koordinimi efikas dhe koherent i të gjitha strukturave dhe institucioneve përgjegjëse për integrimin në BE është thelbësor për të siguruar bashkëpunimin midis të gjithë partnerëve të interesuar, duke pasur parasysh rëndësinë dhe karakterin *sui generis* të kërkesave të procesit të integritimit:

INSTITUCIONET KOORDINUESE DHE STRUKTURAT E INTEGRIMIT NË BE: PSE JANË TË RËNDËSISHME?

EU Policy Hub

- Procesi i integritimit në BE kërkon vizion strategjik, duke përcaktuar interesa dhe prioritete kombëtare si edhe një planifikim të përshtatshëm;
- I gjithë procesi është kompleks - duke përfshirë aspekte politike, ligjore dhe ekonomike – si dhe dinamik, karakterizuar nga fleksibiliteti dhe përgjigje relevante ndaj sfidave dhe nevojave të reja;
- Procesi kërkon realizimin e një sërë reformash dhe masash, të cilat kërkojnë bashkërendim të ngushtë midis të gjitha ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera përkatëse;
- Kërkon zhvillimin organizativ dhe përshtatje në të gjitha nivelet e pushtetit qendror dhe lokal; Përveç koordinimit të institucioneve të ndryshme qeveritare, nevojiten gjithashtu konsultime të vazhdueshme me aktorë të ndryshëm të jashtëm dhe shoqërinë civile.

KORNIZA INSTITUCIONALE NË SHQIPËRI PËR INTEGRIMIN NË BE

Organet kryesore ekzekutive dhe legjislative në Shqipëri, përgjegjëse për koordinimin e procesit të integritimit në BE përfshijnë:

Qeveria e Shqipërisë

Ministria e Integritimit Evropian (MIE) është institucioni kryesor shtetëror që menaxhon dhe koordinon procesin e integritimit në BE të Shqipërisë. MIE ka për mision drejtimin teknik dhe bashkërendimin e procesit të integritimit të Shqipërisë në BE, nëpërmjet hartimit të politikave të integritimit, përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së, monitorimin e zbatimit të

Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe rekomandimeve të BE-së për përbushjen e kritereve të pranimit, bashkërendimin e ndihmave financiare nga BE dhe informimin e publikut për këtë proces.

Rrjeti i Njësive të Integritimit Evropian & Rrjeti i Njësive të Hartimit të Legjislacionit në Ministrinë e Linjës janë krijuar në vitin 2015. Qëllimi kryesor i njësive të integritimit në ministrinë e linjës është të koordinojnë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja, ndërsa roli kryesor i rrjetit të legjislacionit është përmirësimi dhe rritja e cilësisë dhe koherencës së hartimit të legjislacionit dhe përafrimit të tij me *acquis* të BE-së.

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe **Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian** luajnë një rol të rëndësishëm dhe janë përgjegjëse për promovimin, njohjen dhe mbështetjen e procesit të integritimit në nivelet më të larta politike të Bashkimit Evropian.

Më vitin 2009 u krijuan dy struktura të bashkërendimit ndërministror për të drejtuar, monitoruar dhe bashkërenduar realizimin e angazhimeve, të ndërmarra në kuadër të MSA-së, në nivel politik dhe administrativ.

- **Komiteti Ndërmintor për Integrimin Evropian (KNIE)** kryesohet nga Kryeministri ose në mungesë të tij nga Ministri i Integritimit Evropian dhe është përgjegjës për orientimin politik në nivel të lartë dhe monitorimin e të gjithë procesit të integritimit në BE.
- **Komiteti i Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (KKNIE)** kryesohet nga Ministri i Integritimit Evropian dhe përbëhet nga përfaqësues të ministrive të linjës dhe institucioneve të pavarura në nivel zëvendësministri dhe sekretari të përgjithshëm, si edhe përfaqësues të institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe ministrave, në nivel drejtori të përgjithshëm. KKNIE është përgjegjëse për orientimin administrativ në nivel të lartë të procesit të integritimit në BE dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian në nivel institucional.

Grupet Ndërinstitucionale të Punës (GNP-të) për Integrimin Evropian¹ u krijuan në vitin 2009 për çdo kapitull të *acquis*. Në vitin 2014,

baza ligjore u përmirësua sa i përket përbërjes dhe funksionimit të tyre. GNP-të përbëhen nga përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit, ministrinë e linjës, organet e tyre vartëse dhe institucionet publike për fushën përkatëse të *acquis* të BE-së nën përgjegjësinë e tyre. Fushëveprimi i GNP-ve është të sigurojnë koordinimin ndërinstitutional në nivel teknik të detyrimeve që rrjedhin nga integrimi evropian në Shqipëri.

Bordi i Integritimit Evropian (BIE), është një tjetër strukturë monitorimi e nivelit të lartë, kryesuar nga Kryeministri, e krijuar në vitin 2015, përgjegjëse për të monitoruar përbushjen e detyrimeve për hapjen e negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian.

Përveç kësaj, në vitin 2015 u krijuan strukturat dhe autoritetet përkatëse që merren me menaxhimin indirekt të fondeve të BE-së, përkatësisht: **Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA); Zytari Kombëtar Autorizues (ZKA); Struktura e menaxhimit përgjegjëse para ZKA-së; Struktura Operative dhe Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së Bashkimit Evropian**.

Kuvendi i Shqipërisë

Gjatë dy viteve të fundit, ***Kuvendi i Shqipërisë*** ka rishikuar funksionet e tij në lidhje me procesin e integritimit në BE, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rolit ligjor dhe mbikëqyrjes të parlamentit në përgjithësi dhe në veçanti çështjeve që lidhen me integrimin evropian. Në vitin 2015, Kuvendi miratoi me konsensus Ligjin nr. 15/2015, me qëllim forcimin e mëtejshëm të rolit të Parlamentit shqiptar në procesin e integritimit në BE.

Sipas ligjit të lartpërmendur, Kuvendi ngriti Këshillin Kombëtar për Integrimin Evropian (KKIE), si strukturën më të lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian, e cila do të promovojë dhe garantojë bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe do të sigurojë rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritimit në BE. KKIE drejtohet nga Kryetari i Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian dhe zëvendëskryetar i saj është kryesuesi i delegacionit shqiptar në Komitetin Parlamentar për Stabilizim-Asociimin.


1. Urdhër i Kryeministrit, Nr. 183, datë 11.12.2009 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës".

Neni 7 i Ligjit 15/2015 përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e KKIE-së, të cilat detajohen më tej me Vendimin e Byrosë Parlamentare nr. 67, datë 04.05.2016 për [miratimin e Rregullores së KKIE-së](#).

[Komisioni Parlamentar për Integrimin Evropian \(KIE\)](#) është organ i përhershëm i Kuvendit, që ka në fushën e përgjegjësisë së tij: *çështjet e integritimit evropian, përafrimin e*

legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, monitorimin e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga MSA-ja, si dhe të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë. Funksione dhe aktivitete të tjera të KIE-së përfshijnë bashkëpunimin ndërparlamentar me parlamentet kombëtare të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve që janë në proces të anëtarësimit në BE.

Tabela 1: Korniza institucionale në Shqipëri për procesin e integritimit në BE



MANGËSITË DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE MBI KOORDINIMIN INSTITUCIONAL

Ministria e Integritimit Evropian mbetet institucioni më i rëndësishëm në monitorimin e procesit të integritimit evropian. Në këtë mënyrë, bashkëpunimi me strukturat e tjera përgjegjëse është thelbësor për realizimin e sfidave kryesore të procesit të integritimit evropian. [Për përgatitjen e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian \(PKIE\), MEI e koordinon punën me Grupet Ndërinstitucionale të Punës.](#) Bazuar në raportin e saj më të fundit të monitorimit, [realizimi i përgjithshëm i PKIE 2017-2020 \(tremujori 1\) është vlerësuar 54.2%.](#) Referuar këtij treguesi dhe duke patur në konsideratë faktin që MIE kryen edhe funksionin e sekretariatit për secilin nga GNP-të, *niveli i koordinimit ndërinstitucional me GNP-të dhe ministrinë e linjës duhet të intensifikohet në vijimësi përsa i përket nivelit të zbatimit të PKIE-së.*

Referuar [Raportit nr. 1/2017](#) drejtuar Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian, për periudhën

janar-mars 2017, **Komiteti për Koordinimin Ndërinstitucional për Integrimin Evropian ka organizuar** vetëm një takim mw 9 Mars. Bashkëpunimi me këtë strukturë mbetet i rëndësishëm në lidhje me koordinimin e procesit të integritimit në nivel institucional dhe [takimet duhet të zhvillohen 2 herë në muaj](#), të jenë sistematike dhe të shpeshta, siç edhe parashikohet. Raporti i lartëpërmendur dhe [raporti i vitit 2016](#), nuk japin informacion mbi [mbledhjet apo takimet e Komitetit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian \(KNIE\), strukturë e cila duhet të mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj.](#)

Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës ndërmjet MIE dhe **Sekretariatit Teknik të Bordit të Integritimit** është mjaft i rëndësishëm lidhur me plotësimin e pesë prioritetëve kyçe dhe monitorimin e Planit të Masave, [realizimi i të cilit për vitin 2016 është vlerësuar në masën 93%.](#)

Rekomandohet që:

- Për të monitoruar procesin e integritimit evropian duhet të arrihet një nivel gjithëpërfshirës koordinimi ndër-intitucional;
- Publikimi sistematik i raporteve nga ministrinë e linjës në lidhje me përgatitjen e kapitujve të PKIE-së si edhe sugjerimeve, rekomandimeve dhe raporteve të takimeve është mjaft i rëndësishëm;
- Sistemi duhet të harmonizohet në të gjitha fazat e ndryshme të procesit, duke filluar nga planifikimi, monitorimi dhe raportimi.

Kuvendi i Shqipërisë ushtron kontroll politik dhe ligjor në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë dhe e monitoron këtë proces nëpërmjet organeve të tij. Roli i Kuvendit në procesin e integritimit u forcua me miratimin e [Ligjit Nr. 15/2015](#), i cili përcakton edhe marrëdhëniet dhe strukturat përgjegjëse për procesin e integritimit Evropian.

KKIE, [struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian, ka zhvilluar 9 takime](#). Në referencë të procesverbaleve të takimeve dhe Raportit të KE-së 2016 për Shqipërinë, kontributi dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në takimet e KKIE-së mbetet pasive, me [një pjesëmarrje e pakët gjatë diskutimeve](#).

Bazuar në [Raportin Vjetor të Veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2016](#), aktiviteti dhe veprimtaria e KIE-së, renditet ndër më të fundit krahasur me atë të komisioneve të tjera të përhershme të Kuvendit, nëse merret parasysh numri i mbledhjeve të mbajtura dhe seancat dëgjimore me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit.

Tabela 2: Mbledhjet dhe Seancat Dëgjimore të KIE gjatë 2015/2016

Numri i mbledhjeve të KIE	
Viti 2016	26
Viti 2015	38
Seancat Dëgjimore gjatë kontrollit parlamentar (KIE)	
Viti 2016	4
Viti 2015	2

Burimi: Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2016; përpunuar nga vetë autori.

Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend i ofron KIE-së asistencën e nevojshme ligjore në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së. Në tabelën 3, paraqitet numri i [ligjeve të përafuara me acquis të BE-së nga Shtatori 2013](#).

Tabela 3: Ligjet e përafuara me *acquis* të BE-së

Sesioni Parlamentar	Nr. i Ligjeve të përafuara me <i>acquis</i> të BE-së
Sesioni VI: Janar-Korrik 2016	11
Sesioni V: Shtator-Dhjetor 2015	4
Sesioni IV: Janar-Korrik 2015	5
Sesioni III: Shtator-Dhjetor 2014	5
Sesioni II: Janar-Korrik 2014	9
Sesioni I: Shtator-Dhjetor 2013	2

Burimi: Faqe e internetit të Parlamentit; përpunuar nga vetë autori.

Rekomandohet që:

- Për të rritur rolin e koordinimit dhe harmonizimit të shoqërisë civile në procesin e integritimit evropian, KKIE duhet të forcojë kapacitetet dhe mekanizmat duke përfshirë dhe nxitur në mënyrë të vazhdueshme dhe aktive pjesëmarrjen e shoqërisë civile gjatë konsultimeve dhe diskutimeve mbi çështjet e integritimit evropian;
- Roli i shoqërisë civile në KKIE duhet të jetë më aktiv dhe gjithëpërfshirës;
- Pjesëmarrje aktive e të gjithë aktorëve në realizimin e reformave dhe detyrimeve të anëtarësimit, në harmoni me institucionet që koordinojnë e menaxhojnë procesin e integritimit;
- Forcimi i kapaciteteve të Kuvendit për shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së për të garantuar një përafrim sa më cilësor të legjislacionit;
- Në funksion të rolit të Kuvendit në procesin e integritimit, Rregullorja e Brendshme duhet të reflektojë ligjin mbi rolin e parlamentit në procesin e integritimit në BE, miratuar në 2015, rekomanduar gjithashtu në Raportin e KE-së 2016 për Shqipërinë.